



MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY  
MINISTRIA OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE



# Bursat për studentët nga Kosova në Universitetin e Sheffield-it, Fakultetin Ndërkombëtar "City College", 2015-2016

## Për:

- **Studime universitare (Bachelor)**
- **Studime pasuniversitare (Master-me orar të plotë)**
- **Ekzekutiv MBA (me orar jo të plotë)**
- **Doktoratë (me orar të plotë PHD)**

Universiteti i Sheffield-it, Fakulteti Ndërkombëtar, CITY College në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, ofrojnë pesëdhjetë pesë (55) bursa për studentët nga Kosova për studime Universitare (Bachelor), pasuniversitare (Master) - me orar të plotë, MBA (me orar jo të plotë) dhe Doktoratë (PhD me orar të plotë) (Viti i pranimit: 2014-2015). Sipas kësaj iniciative, CITY College synon të mbështesë shkollimin për studentët e dalluar të cilët dëshirojnë të studiojnë në CITY College në Selanik-Greqi dhe të marrin diplomë të pranuar në nivel ndërkombëtar nga Universiteti i Sheffield-it. Studimet do të ofrohen në kampusin e Universitetit të Sheffield-it, CITY College në Selanik.

Universiteti i Sheffield-it është universitet kryesor në Britaninë e Madhe, që vazhdimisht radhitet në mesin e "100 universiteteve më të mira në botë", në "Top 10% tw Universiteteve për Kapacitete Hulumtuese" dhe "I pari sa i përket përmbushjes së nevojave të studentëve". Zë vend në 1% -shin e "Universiteteve më të mira në botë".

Për më shumë informata në lidhje me programet e Fakultetit Ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield-it, CITY College, luteni të vizitoni [citycollege.sheffield.eu](http://citycollege.sheffield.eu)

## **Bursa për studime universitare (Bachelor)**

**Dhjetë (10)** bursa të përbashkëta për **studime universitare** (për 3 vite studimi), sipas skemës në vijim:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (4120 € për student për një vit);

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT-i (4120 € për student për një vit).

**Dhjetë (10)** bursa për **studime universitare** (për 3 vite studimi), sipas skemës në vijim:  
50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (4120 € për student);  
50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studentët (4120 € për student).

Studimet Bachelor zgjasin 3 vite dhe bursat janë në dispozicion për programet në vijim:

### **PROGRAMET UNIVERSITARE: DIPLOMAT BACHELOR (HONS)**

#### **Administrim Biznesi & Departamenti i Ekonomisë**

- BA (Hons) në Studime Biznesi (Menaxhment)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Marketing)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Kontabilitet & Financë)

#### **Departamenti i Shkencave Kompjuterike**

- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Informatikë Biznesi)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Internet Computing)

#### **Departamenti i Psikologjisë**

- BSc (Hons) në Psikologji

#### **Departamenti i Studimeve të gjuhës angleze**

- BA (Hons) në Gjuhë Angleze dhe Linguistikë

Shënim: Përfituesit e bursave pritet të jetojnë në Selanik gjatë studimeve.

#### **Kriteret për programet universitare**

Kandidatët për bursë duhet të plotësojnë kriteret për pranim në programet e City College për të cilat aplikojnë

Kandidatët për programet universitare duhet të kenë diplomë të shkollës së mesme (Diplomën Baccalaureat) me sukses të shkëlqyeshëm (më shumë se 8) dhe duhet të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën angleze (TOEFL: 550 poenë të bazuara në testin me shkrim / 213 poenë të bazuara në kompjuter, ose (IELTS: 6, 0 ose kualifikime të barasvlershëm). Kandidatët të cilët, në kohën e aplikimit, nuk posedojnë ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të përmendura më lartë, kanë të drejtë për aplikim në bursat e ofruara, me kusht që ata të paraqesin kualifikimin e gjuhës angleze në fillim të kursit apo t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze që organizohet nga Universiteti në Kosovë. Studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme apo studimet e tyre universitare në gjuhën angleze nuk janë të detyruar të paraqesin kualifikimin për gjuhën angleze.

#### **[Admission Requirements for Bachelors programmes \(pdf\)](#)**

#### **[Application form for Bachelor's programmes \(pdf\)](#)**

<b>Bursa për Studime Pasuniversitare (Master)</b>
---

**Djetë (10)** bursa të përbashkëta për **studime pasuniversitare me orar të plotë** (1 vit studimesh), sipas skemës në vijim:

- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (5340 € për student);
- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT-i (5340 € për student).

**Dhjetë (15)** bursa për **studime pasuniversitare me orar të plotë** (1 vit studimi), sipas skemës në vijim:

- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (5340 € për student);
- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studentët (5340 € për student).

Studimet Master zgjasin 1 vit (programi me orar të plotë) dhe bursat janë në dispozicion për programet në vijim:

## **PROGRAMET PASUNIVERSITARE: DIPLOMAT MASTER ME ORAR TË PLOTË**

### **Administrim Biznesi & Departamenti i Ekonomisë**

- MSc në Banka & Financa
- MSc në Menaxhment
- MSc në Menaxhment (Menaxhim i Burimeve Njerëzore)
- MSc në Menaxhment (Logjistikë dhe Menaxhim i Zinxhirit të Furnizimit)
- MSc në Menaxhment (Rekreacion & Menaxhim të Turizmit).
- MA në Marketing, Reklama & Marrëdhënie me Publikun
- MA në Marketing Digjital dhe Media Sociale

### **Departamenti i Shkencave Kompjuterike**

- MSc në Inxhinieri Softuerike të Avancuar - Telekomunikacion
- MSc në Inxhinieri Softuerike të Avancuar – Ueb dhe aplikacione mobile (Web and Mobile Applications)
- MSc në Inxhinieri Softuerike të Avancuar – Siguri

### **Departamenti i Psikologjisë**

- MSc në Psikologji Këshillimi
- MSc në Neuropsikologji Kognitive

### **Departamenti i Studimeve të gjuhës angleze**

- MA në Linguistikën e aplikuar dhe TESOL

Shënim: Përfituesit e bursave priten të jetojnë në Selanik gjatë studimeve.

### **Kriteret për programet pasuniversitare**

Kandidatët për bursë duhet të plotësojnë kriteret për pranim në programet e City College për të cilat aplikojnë

Kandidatët për programet pasuniversitare pritet të kenë, apo të jenë gati për ta marrë Diplomën e Nderit (good Class Honours Degree) nga një Universitet apo institucion i ngjashëm. Ata duhet të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën angleze (certifikatë TOEFL: 575 poenë të bazuara në testin me shkrim/ 230 poenë të bazuara në kompjuter, ose (IELTS: 6,5 ose CAE (A ose B) apo kualifikime të barasvlershme). Kandidatët të

cilët në kohën e aplikimit nuk posedojnë ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të përmendura më lartë kanë të drejtë për aplikim në bursat e ofruara, me kusht që ata do të paraqesin kualifikimin e gjuhës angleze në fillim të kursit apo t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze që organizohet nga Universiteti në Kosovë. Studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme apo studimet e tyre universitare në gjuhën angleze nuk janë të detyruar të paraqesin kualifikimin për gjuhën angleze.

[Admission requirements for postgraduate studies \(MA & MSc programmes\)](#)

[Application form for MA and MSc programmes \(pdf\)](#)

## **Bursa për programin ekzekutiv MBA**

**Pesë(5) bursa të përbashkëta për MBA për të punësuarit në sektorin publik, me përjashtim të punonjësve nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas skemës në vijim:**

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (7445 € për student);  
50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studenti (7445 € për student).

Bursat janë në dispozicion për specializimet në programet në vijim të Ekzekutiv MBA (EMBA):

Master në Administrim Biznesi (2 vite, ligjëratat: një fundjavë në muaj)

- MBA në Menaxhment të Përgjithshëm
- MBA në Marketing
- MBA në Financa
- MBA në Logjistikë
- MBA në Menaxhment i Kujdesit Shëndetësor
- MBA në Menaxhment i Burimeve Njerëzore

Shënim: Përfituesit e bursave do të udhëtojnë për në Selanik gjatë fundjavave të caktuara sipas orarit për programet MBA dhe të udhëtojnë për në Sheffield, në Mbretërinë e Bashkuar për një javë në fund të vitit të parë të studimeve. Shpenzimet e udhëtimit për në Sheffield, në Mbretërinë e Bashkuar do të mbulohen nga studenti.

[Admission requirements for the Executive MBA programme](#)

[Application form for the Executive MBA programme \(pdf\)](#)

Kriteret për programet Ekzekutiv MBA

Kandidatët për bursë duhet të plotësojnë kriteret për pranim në programet e City College për të cilat aplikojnë

Kandidatët për programet e Ekzekutiv MBA pritet të kenë Honours Degree (Diplomë) nga Universiteti apo institucioni i ngjashëm. Ata duhet të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën angleze (TOEFL: 575 poenë në testin me shkrim/230 poenë në kompjuter ose (IELTS: 6,5 ose kualifikime ekuivalente). Kandidatët që nuk posedojnë, ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të përmendura më lartë, në kohën e aplikimit kanë të drejtë për

aplikim në bursat e ofruara, me kusht që ata të paraqesin kualifikimin e gjuhës angleze në fillim të kursit apo t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze që organizohet nga Universiteti në Kosovë. Studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme apo studimet universitare në gjuhën angleze nuk janë të detyruar të paraqesin kualifikimin për gjuhën angleze. Moshë minimale e kërkuar është 26 vjeç, ndërsa nevojitet certifikata e përvijës së punës. Kandidatët, gjithashtu duhet të punojnë me orar të plotë në sektorin publik. Kandidatët që punojnë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk kanë të drejtë të aplikojnë për bursat MBA për vitin 2015-2016.

## **Bursat për Diploma Hulumtuese (PhD)**

**Pesë (5)** bursa për studime **(PhD) me orar të plotë**<sup>1</sup> (dy në Studime Biznesi, dy në Shkenca Kompjuterike, një në Psikologji) në SEERC sipas skemës në vijim:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga Universiteti (6,000 funta britanike në vit për 3 vite)

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT (6,000 funta britanike në vit për 3 vite).

Hulumtimet në SEERC trajtojnë tri fusha të gjëra:

- Ndërmarrësia, inovacioni dhe zhvillimi i biznesit dhe ekonomisë
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
- Shoqëria dhe zhvillimi njerëzor: Psikologji, Politikë, Sociologji dhe Arsim.

### Kriteret për programin e doktoratës (PhD)

Kandidatët për studimet e doktoratës (PhD) zakonisht pritet të kenë diplomë të klasës së parë (niveli 2.1 ose më lartë) dhe nivelin e kualifikimit Master në fushën përkatëse. Kandidatët duhet të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze (varësisht nga fusha, IELTS 6.5 - 7.0 ose kualifikim të barasvlershëm). Kandidatët gjithashtu duhet të jetë entuziast, të përkushtuar, me organizim të mirë dhe të jenë në gjendje t'i caktojnë prioritetet e punës sipas nevojës. Përvoja e mëparshme në hulumtime konsiderohet si përparësi.

[http://www.seerc.org/new/docs/Call for PhD Applications Kosovo final.pdf](http://www.seerc.org/new/docs/Call_for_PhD_Applications_Kosovo_final.pdf)

[Application form for Research Degrees \(PhD\) programmes \(pdf\)](#)

[More about the South East European Research Centre \(SEERC\).](#)

## **\*Testi i gjuhës angleze**

Kriteret për njohjen e gjuhës angleze janë cekur qartë në kriteret relevante për pranim dhe aplikim. Të gjithë kandidatët të cilët nuk posedojnë ndonjë prej kualifikimeve të gjuhës angleze të përcaktuara me kriteret e Universitetit do t'i nënshtrohen testit të gjuhës

---

<sup>1</sup>Vini re se programi PhD me orar të plot ka një kohëzgjatje prej 3 viteve (dhe vitin e 4-t në dispozicion për të shkruar tezën) dhe kërkon angazhim me orar të plotë nga ana e studentëve të doktoraturës, që do të thotë se duhet të jenë fizikisht të pranishëm në objektet e SEERC në Selanik.

angleze. Testi do të organizohet dhe mbikëqyret nga përfaqësuesit e Fakultetit Ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield, CITY College. Për të dhënat e mbajtjes së testit të gjuhës angleze kandidatët do të njoftohen me kohë. Kandidatët të cilët posedojnë ndonjë kualifikim të gjuhës angleze që është ekuivalent me atë të përshkruar në linqet "Kriteret për Pranim dhe Aplikim", duhet ta kontaktojnë znj. [ppatsala@cit.academic.gr](mailto:ppatsala@cit.academic.gr) për të verifikuar nëse kualifikimi i tyre është i pranueshëm nga universiteti.

### Procesi i përzgjedhjes për bursistët

Fakulteti Ndërkombëtar "CITY College" i Universitetit të Sheffield-it është përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Procesi i përzgjedhjes do të zhvillohet nga Fakulteti Ndërkombëtar në bazë të kërkesave dhe rregulloreve për pranim.

### Si të aplikoni

Kandidatët e interesuar për bursat e lartpërmendura duhet t'i plotësojnë dhe t'i sjellin aplikacionet e tyre në MASHT. Së bashku me formularin e aplikimit, kandidatët gjithashtu duhet të dorëzojnë edhe të gjitha dëshmitë e kërkuara për kualifikim akademik (një fotokopje të origjinalit si dhe përkthimin zyrtar në gjuhën angleze, të gjitha të vërtetuara nga komuna) siç është specifikuar në Kriteret për Pranim dhe Aplikim në linqet më lartë.

#### Vërejtje:

Ata që nuk kanë diplomuar akoma, mirëpo pritet të diplomojnë deri në korrik 2013, duhet t'i dorëzojnë të gjitha certifikatat e notave që i kanë në dispozicion deri më tani. Komisioni i Bursave do të vendos duke u bazuar në dëshmitë akademike në dispozicion në ditën e përzgjedhjes. Rezultati i testit të maturës apo diploma e universitetit duhet të dorëzohen menjëherë pasi të jenë lëshuar. Për hollësi, luteni të shihni Kriteret relevante për Pranim dhe Aplikim të Universitetit të Sheffield-it në linqet më lartë.

### Dorëzimi i aplikacionit tuaj për bursë

Aplikacionet për bursa dhe të gjitha dokumentet relevante duhet të dorëzohen në zarf në **Zyrën 103, kati i I, Arkiva e MASHT, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me këtë shenim:**

#### Aplikacion për bursë në Universitetin e Sheffield-it

**Për: Znj. Hanëmsha Aliu-Latifi**

**Zyrtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar- MASHT, Zyra nr. 205**

**Tel. 038 213 884 no: 204**

[hanemsha.latifi@rks-gov.net](mailto:hanemsha.latifi@rks-gov.net)

### Procesi i përzgjedhjes për bursistët

- Aplikacionet do të dorëzohen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Kandidatët pa kualifikimin e kërkuar të gjuhës angleze do të hyjnë në testin e gjuhës angleze

- Kandidatët për bursa do të ftohen për intervistë  
Aplikacionet do të shqyrtohen nga Departamentet e Universitetit të Sheffield-it në Selanik.
- Lista përfundimtare e bursistëve do të vendoset nga Komisioni i Bursave
- Rezultatet do të shpallen zyrtarisht në ueb-faqen e Ministrisë dhe të Universitetit.
- Të gjithë kandidatët do të informohen përmes postës elektronike me kohë.

Për më shumë informata lidhur me bursat, luteni të kontaktoni zyrën e Universitetit të Sheffield-it në Prishtinë:

**Znj. Hana Hoxha**  
**Menaxhere e Vendit, Zyra Përfaqësuese**  
**Tringe Ismajli, 1/7, kati i 4-të**  
**10 000, Prishtine, Kosove**  
**Tel: +386 49 422 424**  
**Email: [hhoxha@city.academic.gr](mailto:hhoxha@city.academic.gr)**

**Datat e rëndësishme:**

Afati kohor për aplikim:	E Hënë, 22 Qershor 2015
Intervistat per BA, MA dhe MBA	Të caktohet
Testi i gjuhes angleze	Të caktohet
Shpallja e rezultateve për Bachelor, Master, MBA	Të caktohet
Informata te rendesishme per doctorate:	Please, click <a href="#">here</a>